

KONTRATE DHURIMI E KUOTAVE TE SHOQERISE "ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K

Sot me daten 27/07/2020, ne Seline e Shoqerise "ANTIGONE SUPPLY" SHPK, u paraqiten personalisht Dhuruesi dhe Pranuesi i dhurimit subjekte te kesaj kontrate.

Subjektet e kesaj kontrate me deshire te lire dhe me vullnet te pavesuar, redaktuan kontraten e dhurimit te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise "ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K si me poshte vijon:

NENI 1 DHURUESI

SHOQERIA "ANTIGONE SUPPLY" regjistruar prane organeve kompetente me date 16/01/2020 pajisur me NIPT. (NUIS) M01316045K me seli ne Tirane, Rruga Mine Peza, Pallati 1, Shkalla 1, Ap.4 perfaqesuar nga:

SHOQERIA ITALIAN STYLE SHPK, zoterues i 49% te kuotave, rregjistruar prane organeve kopetente me date 11/12/2018, pajisur me Nr. NIPT (NUIS) L82411016H, me seli ne Tirane, Rruga "Marko Bocari", Pallati TID, dyqani nr.10. Perfaqesuar nga Administratori Aldoljan Ziso, i datl. 25/07/1978, lindur ne Durres, dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimti personal me Nr. H80725199D, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;


SHOQERIA AB INVESTMENTS SHPK, zoterues i 51% te kuotave, regjistruar prane organeve kopetente me date 18/12/2018, pajisur me Nr. NIPT (NIUS) L82418030I, me seli ne Tirane, Vila Antigone, Rruga "Beqir Rusi", Nr.6. Perfaqesuar nga Aministratori Florian Budina , i datl. 24.06.1975, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimtit personal me Nr.H50624048M, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

NENI 2 PRANUESI I DHURIMIT

Z. EDMIR DANO , shtetas shqiptar, linduar ne Fier , me 28/04/1982, dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimtit personal me Nr. I20428176T.;

NENI 3 BAZA LIGJORE

1. Kjo kontrate hartohet ne baze dhe per zbatim te vullnetit te lire dhe te pavesuar te paleve, percaktuar ne nenin 1 dhe nenin 2 si mesiper.
2. Kjo kontrate hartohet edhe ne baze dhe per zbatim te:
 - a) Kodit Civil te Republikes se Shqiperise
 - b) Statutin e shoqerise "ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K;
 - c) Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe ne vecanti neni 73 dhe vijues te tij;
 - d) Vendimit te Asambles se Ortakeve te Shoqerise "ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K me Nr.1, date 27/07/2020 ;





NENI 4 OBJEKTI

1. Kjo kontrate ka per objekt dhurimin e :
 - 1 kuote qe perben 51% te vleres se kapitalit themeltar, qe zoteron dhuruesi **SHOQERIA "AB INVESTMENT" SHPK** ne kapitalin e shoqerine **"ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K.**, qe jane prone e dhuruesit dhe te te gjitha te drejtave qe lidhen me to.
 - 1 kuote qe perben 49% te vleres se kapitalit themeltar, qe zoteron dhuruesi **SHOQERIA "ITALIAN STYLE" SHPK** ne kapitalin e shoqerise **"ANTIGONE SUPPLY" SHPK**, qe jane prone e dhuruesit dhe te te gjitha te drejtave qe lidhen me to.
2. Pranuesi I dhurimit **Z. EDMIR DANO** pranon dhurimin nga ana e shoqerise **"AB INVESTMENT" SH.P.K.** 51% te kuotave te tij ne kapitalit e shoqerise **"ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K.**; dhe shoqerise **"ITALIAN STYLE" SHPK** 49% te kuotave te tij ne kapitalin e shoqerise **"ANTIGONE SUPPLY" SHPK** te cilat perbejne ne total 100% te kuotave te shoqerise **"ANTIGONE SUPPLY"**

NENI 5 KUSHTET E DHURIMIT

Palet bien dakort se kuptat jane subjekt i dhurimit me vullnt te lire dhe pa asnje detyrim pagese te asnje lloji, dhe nuk kane asnje kundërshtim dhe mosmarrveshje per kete fakt ne kohen e redaktimit dhe nenshkrimit te kesaj kontrate.

NENI 6 DETYRIMET E PALEVE

1. Detyrimet e dhuruesit:

- a. Marr persiper dhe deklaroj jam pronar i 100 % te kuotave ne shoqerine **"ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K.**, dhe keto kuota I dhuroj, pa pagese sipas percaktimit ne nenin 5 te kesaj kontrate.
- b. Garantoj pranuesin e dhurimit, se keto kuota jane te lira nga cdo barresim dhe detyrim karshi te treteve, dhe per cdo pretendim qe mund te ngrene te tretet per cenimin e te drejtes se pronesis se pranuesit te dhurimit (eviksjon), une jam i gatshem dhe i detyruar te paraqitem menjehere me kerkesen e pranuesit te dhurimit, dhe te cdo personi tjetër te trete, qe pretendon mbi keto kuota, para gjithë organeve gjyësore dhe administrative per te mbrojtur te drejten e tij, si pronar i ligjshem i ketyre kuotave pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

2. Detyrimet e pranuesit te dhurimit:

- a) Pranuesi I dhurimit ka marre ne dorezim kuotat, duke mos patur asnje verejtje sipas dokumentit ligjor.

3. Detyrimet dy paleshe:

- a. Palet kontraktuese deklarojne se te gjitha detyrimet e pershkruara me lart dhe te gjitha ato qe burojne nga kjo kontrate dhurimi jane realizuar prej tyre dhe ata nuk kane asnje detyrim te ndersjellte midis tyre.
- b. Palet kontraktuese deklarojne se kuotat jane marre ne dorezim nga pranuesi i dhurimit ne gjendjen egzistuese dhe ata nuk ka asnje pretendim ne lidhje me kete veprim.

Mirë Arta
Edmir Dano

[Signature]

NENI 7
PASOJAT TRANZITORE TE KALIMIT TE KUOTAVE

1. Dhuruesi si dhe pranuesi i dhurimit jane solidarish pergjegjes ndaj shoqerise, per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave objek i kesaj kontrate.
2. Pergjegjesia solidar e dhuruesit dhe pranuesit te dhurimit ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave objekt i kesaj kontrate, fillon nga çasti i kalimit te kuotave nepermjet nenshkrimet te kesaj kontrate dhe perfundon me regjistrimin e ketij kalimi ne perputhje me dispozitat e ligjit **Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar.**

NENI 8
EFEKTET E KONTRATES

1. Kalimi i pronesis se kuotave nga dhuruesi tek pranuesi I dhurimit ne peruthje me percaktimet e kesaj kontrate perfundon me regjistrimin e kesaj kontrate prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit **Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar.**
2. Kalimi i kuotave sipas kesaj kontrate regjistrohet ne perputhje me dispozitat e ligjit **Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar.**
3. Regjistrim i percaktuar ne piken 2 te ketij neni ka efekt deklarativ.

NENI 9
DOKUMENTET E BASHKELIDHURA

1. Kesaj kontrate i bashkelidhen dhe konisderohen si pjese e pandashme dokumentet si me poshte vijon:
 - a) Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te shoqerise **"ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K**, Nr. 1, date 27/07/2020.

NENI 11.
DISPOZITA E FUNDIT


1. Keshtu me firmosjen e kesaj kontrate nga palet kontratuese, dhuruesi **"ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K** zhvishet nga pronesia e 100% te kapitalit te shoqerise dhe pronar i tyre behet **Z. EDMIR**
2. **DANO duke gezuar te gjith te drejtet ligjore mbi keto kuota ne shoqerine, "ANTIGONE SUPPLY" SH.P.K.**
3. Palet deklarojne se moren dijeni per kryrjen e regjistrimit te ketij akti noterial ne QKB Tirane sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi

PALET KONTRATUESE

DHURUESI


AB INVESTMENT" SHPK

ITALIAN STYLE SHPK


Mirza Ahmeti

PRANUESI I DHURIMIT

EDMIR DANO


Edmir Dano